



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 27 janar 2020
Nr. ref.:RK 1505/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI174/19

Parashtrues

**Duriye Kurshumlija,
Shpresa Kurshumlija dhe
Orhan Kurshumlija**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të
Republikës së Kosovës, Rev. nr. 127/2019, të 22 majit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga: Duriye Kurshumlija, Shpresa Kurshumlija dhe Orhan Kurshumlija (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës). Ata janë të përfaqësuar nga z. Sabri Kryeziu, avokat nga Lipjani.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, [Rev. nr.127/2019] (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) të 22 majit 2019, me të cilin ishte refuzuar si i pabazuar revizioni i parashtruesve të kërkesës kundër Aktvendimit [Ac. nr. 218/14] të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) të 21 nëntorit 2018, në lidhje me propozimin e parashtruesve të kërkesës për përsëritjen e procedurës kontestimore.
3. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Aktvendimin e kontestuar e kanë pranuar me 7 qershor 2019.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është shqyrtimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesit pretendojnë shkeljen e të drejtave të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 30 shtator 2019, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 4 tetor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërzhaliu-Krasniqi.
8. Më 10 tetor 2019, Gjykata njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
9. Më 16 janar 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesit e kërkesës parashtruan për herë të dytë kërkesë në Gjykatë në lidhje me rastin e tyre, duke kontestuar vendime të ndryshme të gjykatave të rregullta. Për këtë arsye, Gjykata do ta paraqes gjendjen faktike në mënyrë të ndarë për secilin rast individualisht, edhe atë: KI76/13 dhe KI174/19.

Përmbledhja e fakteve në lidhje me kërkesën KI76/13

11. Më 5 nëntor 1985, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin C. nr. 526/84, vërtetoi se babai i parashtruesve të kërkesës kishte të drejtën e shfrytëzimit të përhershëm të paluajtshmërisë, e cila figuron si parcelë kadastrale nr. 6177 në sipërfaqe prej 1.67,53 hektarësh në vendin e quajtur "Vreshtat", sipas fletëposedimit nr. 1941 KK Prishtinë, dhe të lejojë regjistrimin në emrin e tij në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e nxjerrjes së Aktgjykimit.
12. Pas kësaj, pala e kundërt (i padituri) u ankua në Gjykatën Supreme, duke u ankuar se Gjykata e Qarkut ka shkelur dispozitat esenciale të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejme: LPK), ka vërtetuar në mënyrë të gabuar situatën faktike dhe në mënyrë të gabuar ka zbatuar të drejtën materiale.
13. Më 17 korrik 1986, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Ac. nr. 125/86, prishi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, duke deklaruar se pretendimet e palës së kundërt nga ankuesi (paditësi para Gjykatës së Qarkut) ishin të arsyetuara, dhe urdhëroi që rasti të dorëzohet për shqyrtim në Gjykatën Komunale në Prishtinë si gjykatë kompetente për të vendosur për këtë rast. Gjykata Supreme më tej urdhëroi që në procedurën e përsëritur, të gjitha rrethanat duhet të qartësohen, *inter alia*, duke kërkuar një raport të detajuar nga Departamenti i Gjeodezisë për kontestin pronësor.
14. Në një datë të pacaktuar, pas vdekjes së babait të tyre, parashtruesit e kërkesës si trashëgimtarë legjitimë iniciuan procedurën e përsëritur në Gjykatën Komunale në Prishtinë ashtu siç urdhërohej me Aktgjykimin Ac. nr. 125/86 të Gjykatës Supreme, të 17 korrikut 1986.
15. Më 14 shtator 2007, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktgjykimin C. nr. 180/2002, refuzoi padinë e parashtruesve si të pabazuar, duke e konsideruar palën e kundërt (të paditurin) si pronar të ngastrës zyrtarisht të regjistruar në emrin e tij në Zyrën Kadastrale në Prishtinë.
16. Më 6 nëntor 2007, parashtruesit ushtruan ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, duke pretenduar se gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar sipas udhëzimeve të përcaktuara në Aktgjykimin Ac. nr. 125/86 të Gjykatës Supreme, të 17 korrikut 1986 dhe ka shkelur nenin 354. 1 në lidhje me nenin 377 dhe 354. 2 të LPK-së, dhe se Aktgjykimi i saj ishte rezultat i përcaktimit të gabuar dhe jo të plotë të situatës faktike të së drejtës materiale.

17. Më 24 qershor 2010, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin Ac. nr. 424/2008, vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale dhe refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesve. Gjykata theksoi se, Gjykata Komunale në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka përcaktuar të gjitha faktet që ishin me rëndësi vendimtare për të përcaktuar faktin se babai i ndjerë i parashtruesve nga Prishtina, nuk ka gëzuar të drejtën e pronësisë së pasurisë së paluajtshme të kontestuar. Gjykata e Qarkut konkludoi se Aktgjykimi i Gjykatës Komunale përmbante një dispozitiv të kuptueshëm dhe se, në arsyetimin e Aktgjykimit, ishin paraqitur arsyet e plota dhe të kuptueshme përkitazi me të gjitha faktet të cilat ishin relevante për gjykimin e drejtë të çështjes së kontestuar.
18. Më 5 gusht 2010, parashtruesit paraqitën revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të LPK-së dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Gjykatës Supreme që vendimet e gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen ashtu që kërkesa e parashtruesve të pranohet si e bazuar, ose që këto aktgjykime të anulohen dhe që çështja të kthehet në rigjykim.
19. Më 7 shkurt 2013, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Rev. nr. 218/2013, refuzoi revizionin si të pabazuar dhe pranoi të gjitha të gjeturat faktike dhe ligjore të nxjerra nga gjykatat e instancës më të ulët, duke theksuar se aktgjykimet e kontestuara ishin të qarta dhe nuk përmbanin kundërrthënie në përmbajtjen ose arsyetimin e tyre.
20. Më 29 maj 2013, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën KI76/13 në Gjykatë duke kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [Rev. nr. 218/2010] të Gjykatës Supreme.
21. Më 28 mars 2014, Gjykata Kushtetuese nxori Aktvendimin për papranueshmëri në rastin KI76/13, e refuzoi kërkesën e parashtruesve në tërësi, duke deklaruar një pjesë të kërkesës si qartazi të pabazuar, ndërsa pjesën tjetër të kërkesës që kishte të bënte me kohëzgjatjen e procedurës e hodhi poshtë për shkak të mosshterjes së mjeteve juridike.

Përmbledhja e fakteve në lidhje me kërkesën e tanishme KI174/19

22. Më 3 prill 2013, parashtruesja e kërkesës Shpresa Kurshumlja paraqiti kërkesë në Gjykatën Themelore për përsëritjen e procedurës kontestimore (objekt shqyrtimi në rastin KI76/13), duke pretenduar, mes tjerash, se kanë fakte të reja, dhe se me këtë rast ishin plotësuar kushtet për përsëritjen e procedurës.
23. Më 11 tetor 2013, Gjykata e Apelit, duke vendosur në instancë të parë, përmes Aktvendimit [CN. nr. 16/13], refuzoi si të pabazuar propozimin e parashtruesve të kërkesës për përsëritjen e procedurës, duke arsyetuar, mes tjerash, se nuk ekzistojnë shkaqe ligjore të cilave i referohet propozimi. Mbi këtë bazë, Gjykata e Apelit kishte vendosur se nuk ishin plotësuar kushtet ligjore për të lejuar përsëritjen e procedurës në lidhje me rastin e parashtruesve të kërkesës.
24. Parashtruesja e kërkesës Shpresa Kurshumlja parashtroi ankesë ndaj Aktvendimit të Gjykatës së Apelit [CN. nr. 16/13], për shkak të shkeljeve

esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

25. Më 21 nëntor 2018, Gjykata e Apelit, duke vendosur në instancë të dytë, përmes Aktvendimit [Ac.nr.218/2014] refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit [CN. nr. 16/13].
26. Më 24 dhjetor 2018 parashtruesja e kërkesës Shpresa Kurshumlija parashtroi revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit [Ac.nr.218/2014], për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
27. Më 22 maj 2019, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev.nr.127/2019] e refuzoi revizionin e parashtrueses së kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 218/2014] të 21 nëntorit 2018.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se me vendimin e kontestuar, Gjykata Supreme ka bërë shkelje të barazisë para ligjit të garantuar me nenin 24 si dhe të drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
29. Parashtruesit e kërkesës në lidhje me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së pretendojnë se Gjykata e Apelit dhe Supreme nuk kanë vlerësuar drejtë propozimin e parashtruesve të kërkesës për përsëritje të procedurës, për më tepër, me deklaratat e pasardhësve të F. S. do të vërtetohej një gjendje tjetër faktike e cila do të kishte pasojë juridike në vendimin e gjykatës.
30. Më tej, parashtruesit e kërkesës përsërisin se shqyrtimi i parregullt i pretendimeve të tyre nga ana e Gjykatës së Apelit dhe nga Gjykata Supreme, që është argumentuar në deklaratat e trashëgimtarit F.S. e përforcon bindjen e parashtruesve të kërkesës se nuk ka ardhur deri te zbatimi i nenit 31 të Kushtetutës, e as te zbatimi i nenit 6 të KEDNJ-së.
31. Parashtruesit e kërkesës në lidhje me shkeljet e pretenduara të nenit 24 të Kushtetutës pretendojnë se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme kanë bërë shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, sepse siç theksojnë ata në një rast tjetër *“gjykata e njëjtë (Gjykata e Apelit e Republikës së Kosovës), me vendimin Ca. nr. 2108/15 të datës 27.06.2019”*, sipas kërkesës së njëjtë për përsëritje të procedurës, Gjykata e Apelit e ka aprovuar ankesën dhe e ka prishur aktvendimin e Gjykatës Themelore.
32. Në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që të anulohen Aktvendimi i Gjykatës së Apelit [CN.nr.16/2013], i 11 tetorit 2013, Aktvendimi i Gjykatës së Apelit [Ac.nr. 218/2014], i 21 nëntorit 2018, dhe Aktvendimi i Gjykatës Supreme [Rev.nr.127/2019], i 22 majit 2019.

Pranueshmëria e kërkesës

33. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
34. Gjykata rikujton se parashtruesit kanë parashtruar dy kërkesa në Gjykatën Kushtetuese. Kërkesa e parë, që kishte të bënte me procedurën kontestimore të parashtruesve të kërkesës ishte deklaruar nga Gjykata si e papranueshme përmes Aktvendimit për papranueshmëri në rastin KI76/13.
35. Në kërkesën e tanishme KI174/19, parashtruesit e kërkesës kontestojnë para Gjykatës vendimet e gjykatave të rregullta që ndërlidhet me propozimin e tyre për përsëritjen e procedurës që kanë përfunduar me Aktvendimin [Rev.nr.127/2019] e Gjykatës Supreme. Rrjedhimisht, Gjykata do të kufizohet vetëm në vlerësimin e vendimeve të gjykatave të rregullta që ndërlidhen me përsëritjen e procedurës, pasi që kjo është objekt i çështjes së kërkesës KI174/19.
36. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1.Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

37. Më tej, Gjykata gjithashtu vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë të parapara me Ligj. Në këtë kuptim, Gjykata së pari i referohet neneve 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës], dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët parashohin:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. [...]”

38. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar të cilët kontestojnë një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin[Rev.nr.127/2019] e 22 majit 2019 të Gjykatës Supreme.
39. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet paragrafëve 2 dhe 3 (b) të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, të cilët parashohin:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

“(3) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse ndonjë nga kushtet në vijim është i pranishëm:

[...]

(b) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën;

[...]

40. Gjykata më tej vëren se parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, prandaj gjykata do t'i përgjigjet në mënyrë të ndarë këtyre pretendimeve të parashtruesve të kërkesës.

Vlerësimi i Gjykatës i pretendimeve të parashtruesve të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së që kanë të bëjnë kërkesën për përsëritje të procedurës.

41. Gjykata gjithashtu përsërit se në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës *“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.*
42. Sa i përket pretendimit të parashtruesve të kërkesës për shkelje të të drejtës së tyre për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata, duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe praktikës gjyqësore të saj, përsërit se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së nuk zbatohen në kërkesat për të rihapur apo përsëritur procedurën (shih, në mënyrë analoge, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI80/15, KI81/15 dhe KI82/15, parashtrues *Rrahim Hoxha*,

Aktvendim për papranueshmëri, i 6 dhjetorit 2016, paragrafi 31; shih gjithashtu rastet e GJEDNJ-se, *inter alia*, *Oberschlick kundër Austrisë*, nr. 23727/94, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 marsit 1994, *Dowsett kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 8559/08, Aktvendim për papranueshmëri, i 4 janarit 2011, *Sablon kundër Belgjikës*, nr. 36445/97, Aktgjykim i 10 prillit 2001, paragrafi 86).

43. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se në të gjitha rastet kur nëpërmjet mjeteve të jashtëzakonshme është kërkuar rishikimi ose përsëritja e procedurave të përfunduara (civile, penale, përmbarimore) me vendime të plotfuqishme, kur gjykatat e rregullta janë marrë vetëm me kriteret e lejueshmërisë së kërkesave e jo me meritat e çështjes, Gjykata në pajtueshmëri me jurisprudencën e GJEDNJ-së ka konstatuar, se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së nuk janë të aplikueshme. (Shih, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI159/15, *Sabri Ferati*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 13 qershorit 2016, KI07/17, *Pashk Mirashi*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 29 majit 2017, dhe KI06/18, *Shkumbin Mehmeti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 14 shkurtit 2019).
44. Gjykata thekson se pajtueshmëria *ratione materiae* e kërkesës me Kushtetutën rrjedh nga juridiksioni material i Gjykatës. E drejta në të cilën thirret parashtruesi i kërkesës duhet të mbrohet me Kushtetutë, në mënyrë që një ankesë kushtetuese të jetë në pajtim *ratione materiae* me Kushtetutën. Megjithatë, Kushtetuta nuk i garanton parashtruesit të kërkesës të drejtën për rishikim dhe përsëritje të procedurës (shih, në mënyrë analoge, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI80/15, 81/15 dhe 82/15, *Rrahim Hoxha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 dhjetorit 2016, paragrafi 33 dhe KI07/17/15, *Pashk Mirashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 qershorit 2017, paragrafi 66;).
45. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesve të kërkesës lidhur me refuzimin nga gjykatat e rregullta për të përsëritur procedurën nuk është *ratione materiae* në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me pretendimin e parashtruesve për shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.

46. Sa i përket pretendimit të parashtruesve të kërkesës për shkelje të barazisë para ligjit të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se, Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme nuk kanë bërë vlerësim të barabartë sepse në disa raste tjera të njëjta me rastin e tyre, Gjykata e Apelit ka vendosur ndryshe.
47. Gjykata në vijim do ta shqyrtojë këtë pretendim specifik, ku parashtruesit e kërkesës i referohen një vendimi të Gjykatës së Apelit (CA.nr.2108/2015, i 27 qershorit 2019), në të cilin rast Gjykata e Apelit kishte kthyer rastin në rigjykim për arsye se kishte konstatuar se provat e prezantuara nga pala nuk ishin marrë për bazë nga gjykata e shkallës së parë.
48. Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në lidhje me nenin 24 të Kushtetutës, e cila thotë se “diskriminimi përbën një trajtim të ndryshëm, pa arsyetim objektiv dhe racional, ndaj personave në situata relativisht të

ngjashme” (shih: *Willis kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 48, aktgjykimi i GJEDNJ-së i 11 shtatorit 2002; *Bekos dhe Koutropoulos kundër Greqisë*, paragrafi 63, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 13 Marsit 2006).

49. Në mënyrë që pretendimet e parashtruesve të kërkesës për diskriminim të jenë të suksesshme, parashtruesit e kërkesës duhet të dëshmojnë, ndër të tjera, që situata e tyre mund të konsiderohet e ngjashme me atë të një personi tjetër që ka pasur një trajtim më të mirë (shih: *Fredin kundër Suedisë* (nr. 1), paragrafi 60, aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 18 shkurtit 1991).
50. Gjykata vëren se në rastin konkret parashtruesit e kërkesës nuk u përpoqën në asnjë mënyrë të “dëshmonin se situata e tyre mund të konsiderohej e ngjashme me atë të një personi tjetër që pati një trajtim më të mirë”.
51. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës janë thirrur vetëm në një vendim të Gjykatës së Apelit me të cilin është lejuar përsëritja e procedurës, pa shpjeguar se cilat ishin ngjashmëritë midis rastit së tyre dhe rastit në cilin ata janë thirrur, si dhe pa shpjeguar se cili është “trajtimi i ndryshëm, pa arsyetim objektiv dhe racional, ndaj personave në situata relativisht të ngjashme”.
52. Për shkak të gjithë asaj që u tha më sipër, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës janë qartazi të pabazuara në përputhje me rregullin 39 (2), sepse parashtruesit e kërkesës nuk kanë dëshmuar dhe mbështetur sa duhet pretendimin e tyre.

Përfundim

53. Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në procedurën sipas kërkesës për përsëritje të procedurës nuk janë *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën. Andaj këto pretendime duhet të refuzohen si *ratione materiae* të papajtueshme, në përputhje me rregullin 39 (3) (b) të Rregullores së punës.
54. Ndërsa sa i përket pretendimit të dytë, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, janë të pabazuara. Prandaj, këto pretendime duhet të refuzohen si qartazi të pabazuara, në përputhje me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 39 (2), (3) (b) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 16 janar 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- I. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- II. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Radomir Laban

Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

Arta Rama-Hajrizi